



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

KESHILLI BASHKIAK BELSH

Belsh më 19/ 09 / 2025

PROCES - VERBAL

“I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Belsh datë 19.09.2025”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar zyrtarisht nëpërmjet e-mail.

➤ **Janë prezent në mbledhje 15 këshilltarë:**

1. Sami Uruçi
2. Erion Gjoshi
3. Erjon Qafa
4. Naime Ibrahim
5. Nexhip Elezi
6. Aleksander Idrizi
7. Fadil Zdrava
8. Dorina Meta
9. Aurjola Bezati
10. Kujtim Dervishi
11. Gazeli Hysa
12. Blerim Kuqja
13. Nertila Uruçi
14. Bujar Blloku
15. Gezim Gjoshi

- Hapet mbledhja e këshillit bashkiak nga kryetari i këshillit. Kryetari i këshillit lexon rendin e ditës. Hidhet në votim rendi ditës dhe miratohet me 13 vota pro dhe 1 kundër.
- Hidhet në votim proces verbali i mbledhjes dhe miratohet me 10 vota pro, 1 abstenim dhe 3 kundër.
- Diskutohet pika nr.3, për miratimin e ndihmës ekonomike 6%. Prezanton projekt vendimin Rexhina Blloku.
- Erion Gjoshi: Këtyre familjeve u jepet një mundësi për punësim?
- R.Blloku: Jo nga ana bashkisë, por aplikojnë te zyra e punës.
- Sami Uruçi : Nëse je pensionist mund ta marrësh 6%?

- R.Blloku: Po, mund ta marrësh 6% edhe pse je pensionist.
- Bujar Blloku: A kanë mundësi personat që marrin 6% të marrin ndihmë ekonomike?
- R.Blloku : Duhet të kalojë një periudhë 1-vjeçare, dhe më pas të aplikojnë për ndihmë ekonomike.
- Kujtim Dervishi: Hidhet në votim projekt vendimi për 6% dhe miratohet me 15 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.4 e rendit të ditës, “Për një ndryshim në buxhetin 2025”. Prezanton Alban Nipolli projekt – vendimin.
- Aurjola Bezati: Është ndryshim për kalimin e pagave të stafit ky projekt?
- A.Nipolli: Fondi transferohet nga fondi i pagave te Agjensia e Funksioneve të Patransferueshme për punonjësit e shërbimeve.
- Blerim Kuqja: Kur përfundon ndryshimi i destinacioneve të buxhetit?
- A.Nipolli: Deri në 15 nëntor 2025.
- Nertila Uruçi: A ka ndryshim në numrin e punonjësve të shërbimit?
- A.Nipolli : Jo, nuk ka ndryshime.
- Gazeli Hysa: Ka njerëz që nuk e kanë emërimin në punë dhe punojnë në vënd të të afërmeve të tyre?
- A.Nipolli : Është shkelje ligji dhe nuk lejohet.
- Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro dhe 2 kundër pika nr.4 e rendit të ditës.
- Kalojmë te pika nr.5 “Për dhënien në përdorim të sipërfaqes së caktuar të fondit pyjor kullor në pronësi të Bashkisë Belsh”. Prezanton projekt vendimin Anxhela Dervishi.
- A.Bezati: Këto toka a menaxhohen nga individë?
- A.Dervishi: Jo ,janë toka në pronësi të Bashkisë Belsh.
- G.Hysa : Në lidhje me një parcelë jeni në gjyq me qytetarët.
- A.Dervishi: Në dijeninë time jemi në gjyq për shkuljen e ulla. Nuk di personat që e kanë zaptuar por di që kemi një çertifikatë në pronësi të Bashkisë.
- G.Hysa: Ne jemi në proces gjyqësor me Bashkinë Belsh.
- S.Uruçi: (drejtuar Gazeli Hyses) Nëse janë në pronësi të Bashkisë, atëherë duhet të shkosh në gjykatë për këtë tapi.
- N.Uruçi: Nëse prona është në gjykatë si mund të japësh në përdorim dikujt tjetër?
- K.Dervishi: Të gjithë kanë pretendime pronash në të gjithë Shqipërinë. Nëse një pronë ta kthen gjykata ,duhet dhe kthimi nga kompensimi i pronave (Agjensia).
- A.Dervishi : Në një rast të ngjashëm , i cili i drejtohet Agjensisë së Pronave, është kompensuar në një vënd tjetër dhe jo aty ku kishte pretendimin.
- E.Gjoshi: Prona në fshatin Seferan ku ndodhet?
- A. Dervishi: Është kufiri me liqenin e merhojës.
- B.Kuqja : Cilët do të jenë kriteret e dhenies në përdorim?
- A.Drvishi: Do të jetë me ankand, dhe do vendosim kriteret sipas ligjit për agropylltari.
- K.Dervishi : Kush është pro ? Hidhet në votim dhe nuk miratohet me 10 vota pro ,3 kundër dhe 1 abstenim. Anëtar G.Hysa nuk mori pjesë në votim.
- Kalojmë te pika nr.6 e rendit të ditës. Prezanton Barometrin në lidhje me barazinë gjinore Aurel Plaku (përfaqësues i “ Bashkitë e Forta”). Informacioni ka të bëjë me barazinë gjinore në Bashkinë Belsh.
- Kalojmë te të ndryshmet. Janë 4 raste që kërkojnë ndihmë financiare nga ana e Bashkisë.
- K. Dervishi : Ta diskutojmë që të bëhet një ndarje jo e barabartë.

- Propozoj që Agron Abazit ti kalojmë 100.000 lekë , Florenc Elezit 100.000, Ferdinand Zdrava 50.000 lekë dhe Zhaneta Dervishi 50.000. - Kujtim Dervishi
- Hidhet në votim propozimi i kryetarit të këshillit dhe miratohet me 15 vota pro.

Mbyllet mbledhja me 3 vendime të miratuara.

Përgatiti :

SEKRETARI I KËSHILLIT

Endri PEPA

